



Në bazë të Rregullores nr. 03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese, në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Ligjit Nr. 04/L-077, për Marëdhënjet e Detyrimeve, si dhe Vendimit nr. 01-94-2023 të KQZ, të datës 27.01.2023 për miratimin e planit të rekrutimit për vitin 2023, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shpall:

K O N K U R S

KQZ 07/2023 Titulli i punës: Shofer i anëtarit të KQZ-së

Grada/Koeficienti:	Koeficienti 6
Mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë:	Udhëheqësi i Divizionit për Logjistikë dhe Transport
Kohëzgjatja e emërimit:	Me afat të caktuar
Numri i pozitave:	1 pozitë
Vendi:	Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të vendit të punës:

Bënë vozitjen e personelit sipas nevojave që kërkohen;
Sipas kërkesave ofron asistencë teknike dhe administrative për KQZ-në;
Mirëmban automjetet dhe ushtron kontrill ditor;
Mban evidencen e kilometrave të kaluara;
Plotëson formularin kur evidentohen kilometrat;
Kryen edhe detyra tjera që i kërkohe nga mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë.

Kualifikimi, aftësitë dhe përvoja e punës:

Të ketë së paku diplomë të shkollës së mesme,
Të ketë patentë shoferi së paku tre (3) vite më herët.
Të ketë përvojë pune në këtë lëmi.

Aftësi dhe gatishmëri për të punuar në mënyrë të paanshme dhe me njerëz të përkatësive të ndryshme etnike.

KQZ 08/2023 Titulli i punës: Zyrtar për burime njerëzore

Grada/Koeficienti:	Koeficienti 8
Mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë:	Udhëheqësi i Divizionit të Personelit
Kohëzgjatja e emërimit:	Me afat të caktuar
Numri i pozitave:	1 pozitë
Vendi:	Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të vendit të punës:

Ndihmon udhëheqësin e divizionit të personelit në zbatimin e fushave të procedurave të punësimit të personelit në SKQZ, duke zbatuar legjislacionin në fuqi;
Ndihmon në përgatitjen e konkurseve, përgatitjen e dosjeve, raporteve dhe kontratave të punës,
Ndihmon në menaxhimin e rekrutimit të personelit në SKQZ;
Kujdeset për aspektet administrative të zyrës;
Detyra dhe përgjegjësi të tjera që i caktohen nga mbikëqyrësi.

Kualifikimi, aftësitë dhe përvoja e punës:

Diplomë Universitare në drejtësi, ekonomi, administratë publike
Së paku dy (2) vite përvojë pune;
Përvojë pune profesionale në zgjedhje (e dëshirueshme);
Integritet të lartë personal dhe profesional;
Shkathtësi të shkëlqyera në komunikim me gojë dhe me shkrim në gjuhët zyrtare;
Aftësi dhe gatishmëri për të punuar në mënyrë të paanshme dhe me njerëz të përkatësive të ndryshme etnike;
Njohje të punës me kompjuter (Ms Word, Ms Excel, Ms Access);
Njohja e gjuhës tjetër zyrtare (e dëshirueshme);
Njohje e gjuhës angleze (e dëshirueshme).

KQZ 09/2023 Titulli i punës: Zyrtar për kontrollimin e raporteve financiare të subjekteve

politike

Grada/Koeficienti:	Koeficienti 8
Mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë:	Zyrtari i Lartë për Parti dhe Subjekte Politike
Kohëzgjatja e emërimit:	Me afat të caktuar
Numri i pozitave:	2 pozita
Vendi:	Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të vendit të punës:

Kryen kontrollimin elektronik të raporteve financiare vjetore, të audituara, dhe raporteve financiare të fushatës,
Identifikon të dhënat personale nga këto raporte dhe kujdeset që të gjitha të dhënat personale të mbulohen,
Raporton në baza ditore për kontrollimin e raporteve dhe i dërgon ato tek mbikëqyrësi me qëllim të publikimit në ueb faqen e KQZ-së,
Raporton drejtëpërdrejt te Zyrtari i Lartë për Parti dhe Subjekte Politike;
Kryen detyra tjera që i caktohen nga Mbikëqyrësi;

Kualifikimi, aftësitë dhe përvoja e punës:

Diplomë Universitare ose student i vitit të fundit;
Aftësi dhe gatishmëri për të punuar me njerëz të përkatësive të ndryshme kulturore dhe etnike;
Aftësi të shkëlqyeshme për futje të të dhënave;
Së paku një vit përvojë pune;
Përvojë pune profesionale në zgjedhje (e dëshirueshme);

Shkathtësi të trajtimit të dokumentacioneve fizike dhe elektronike;
Njohje të punës me kompjuter (Ms Word, Ms Excel, Ms Access);
Njohja e gjuhës tjetër zyrtare (e dëshirueshme);
Njohje e gjuhës angleze (e dëshirueshme).

Mënyra e aplikimit:

Formularët për punësim mundë të merren në zyrën e personelit apo në webfaqen e KQZ-së, në linkun www.kqz-ks.org. *Formularët për punësim dorëzohen brenda afatit të përcaktuar me konkurs, në zyrën e personelit në SKQZ , Rruga “Migjeni, nr. 21. 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, përmes postës elektronike në adresën: zyra.personeli@kqz-ks.org dhe me anë të shërbimit postar.*

Formularit për punësim i bashkëngjiten kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe dëshmitë për kualifikim, përvojë të punës, trajnimet e ndjekura dhe Certifikatën (dëshminë) që nuk jeni nën hetime.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe inkurajon aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, si dhe pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë, përfshirë personat me aftësi të kufizuar. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e pakompletuara refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listë të ngushtë do të kontaktohen.

Afati i aplikimit është i hapur tetë (8) ditë kalendarike nga data 30.01.2023 deri me 06.02.2023.

Për informata shtese ju lutem kontaktoni në numrin e telefonit 038-200-23-557.